

VENDIM
Nr. 191, datë 9.3.2016

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHETËTËRORE PËR SISTEMIN E SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shetëtorore”, dhe të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shetëtorore për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP). Baza e të dhënave të SHKP-së quhet Sistemi i Shërbimeve të Punësimit (SSHP).

2. Sistemi i Shërbimeve të Punësimit (SSHP) përmban të dhëna për:

- a) punëkërkuesin;
- b) punëdhënësin;
- c) vende të lira pune.

3. Institucioni administrues i SSHP-së është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

4. Të dhënat e SSHP-së mbliidhen në kohë reale dhe kategorizohen në të dhëna parësore e dytësore.

5. Të dhënat parësore konsiderohen të dhënat e:

- a) punëkërkuesit:
 - punëkërkues i papunë;
 - punëkërkues në punë;
 - punëkërkues aktiv ose i çregjistruar.
- të dhëna për nivelin arsimor, kurse profesionale, aftësi të tjera, eksperiencia në punë dhe profesionet e dëshiruara (CV-ja e vetëdeklaruar e punëkërkuesit);
- përfitues i shërbimeve të punësimit;
- përfitues nga programe të nxitjes së punësimit;
- përfitues i kurseve të formimit profesional publik;

- përfitues nga programi i pagesës së papunësisë.

b) punëdhënësit:

- të dhëna për personin e kontaktit;
- shërbime që i ofrohen;
- përfitues nga programet.

c) vendet e lira të punës:

- të dhëna për vendin e lirë të punës (adresën, numrin e vendeve të lira, profesionin, pagën, orët e punës, arsimimin dhe aftësitë e kërkuara.

6. Të dhënat dytësore konsiderohen të dhënat e:

a) punëkërkuesit, të dhënat personale të të cilit verifikohen nga regjistri i Gjendjes Civile (RGJC). I punësuar verifikohet, gjithashtu, nga regjistri i tatimeve (DTP) dhe trajtimi i tij me ndihmë ekonomike verifikohet nga Shërbimi Social Shtetëror;

b) Punëdhënësit, të dhënat e të cilit verifikohen nga Qendra Kombëtare e Regjistrimeve (QKR) dhe të dhënat e punëmarrësve në ndërmarrje, të cilat verifikohen nga regjistri i tatimeve (DTP).

7. Dhënës të informacionit për SSHP-në janë punëdhënësit, punëkërkuesit dhe institucionet e tjera, me të cilat ai ndërvepron.

8. Baza e të dhënave të SHKP-së shkëmben informacion me institucione publike, që ushtrojnë funksione publike, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shetëtorore”, lidhur

me shërbimet që ofrohen. Bazuar në legjislacionin në fuqi:

a) institucionet, nga të cilat SSHP-ja merr të dhëna parësore, janë:

- Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

Institucione të tjera, me të cilat SSHP-ja ka interes të ndërveprojë, janë: Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe institucione të tjera shtetërore, të cilat mund të ngarkohen me akte ligjore e nënligjore.

b) institucionet, për të cilat SSHP-ja jep të dhëna parësore, janë:

- Shërbimi Social Shtetëror;
- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- Institucione të tjera publike, të cilat kanë interes të ndërveprojnë me SSHP-në.

9. Subjektet e interesuara (punëdhënës dhe punëkërkuar) kanë nivel aksesit për të hedhur dhe lexuar informacion të kufizuar, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, nëpërmjet sistemit të SSHP-së, si dhe shërbimit *on-line*. Për punonjësit e SHKP-së, niveli i aksesimit përcaktohet me rregullore të brendshme, sipas dispozitave ligjore.

10. Baza e të dhënave të SHKP-së ka këto nivele përdoruesish:

- a) nivel administrator;
- b) nivel drejtues;
- c) nivel raportues;
- ç) nivel specialist;
- d) përdorues të jashtëm (punëkërkuar dhe punëdhënës).

Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës dhe të përcaktuara në përshkrimet e punës, të miratuara nga drejtori i Përgjithshëm i SHKP-së, për secilin nga punonjësit e saj.

11. Subjektet e interesuara janë punëkërkuar dhe punëdhënësit.

12. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* dhe në strukturën e SSHP-së të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane e ndërkombëtare në fushën e shërbimeve të punësimit, do të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

13. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi